Kronikë

Lezhë, shpërthimi në banesën ku jetonte e vetme 80 vjeçarja, i biri në emigrim! Familjarët: S'kemi konflikte! Autori përfitoi nga errësira, iku pa lënë gjurmë

Një banese dy katëshe u sulmua me lëndë plasese në Lezhë, por fatmiresisht nuk pati përsona të lënduar. Ngjarja ndodhi rreth orës 23:00 të së shtunës në shtëpinë Aleks Ivanajt në fshatin Ishull-Shëngjin.

- VIDEO/ Policia në banesën ku ndodhi shpërthimi
- Në banesën e Aleks Ivanajt u hodh kapsollë detonatore

Elvis Hila
4 Shkurt, 08:17 | **Përditesimi: 4 Shkurt, 10:39**

Share

Një banesë dy katëshe u ***sulmua*** me lëndë plasese në Lezhë, por fatmiresisht nuk pati përsona të lënduar. Ngjarja ndodhi rreth orës 23:00 të së shtunës (3 shkurt 2024) në shtëpinë Aleks Ivanajt në fshatin Ishull-Lezhë.

Lënda plasëse u hodh nga përsona të paidentifikuar në oborrin e shtëpisë. Në momentin e ngjarjes brenda baneses ishte një e moshuar 80-vjeçare nëna e të zotit të shtëpisë, pasi kryefamiljari sëbashku me familjen ndodhet prej vitesh në emigrim. Nga shpërthimi pati dëme të vogla materiale, ndërsa policia e cila mbërriti menjëhere në vendin e ngjarjes nisi hetimet në lidhje me rastin. Nga verifikimet paraprake bëhet me dije se brenda shtëpisë është hedhur një kapsollë detonatore e cila ka shpërthyer.

Pjestaret e familjes Ivanaj kanë deklaruar në polici se nuk kanë konflikte, ndërsa blutë vijojnë veprimet hetimore për për sqarimin e plotë të rrethanave, identifikimin dhe kapjen e autorit, i cili mendohet se ka qenë një person dhe duke përfituar nga erresira ka arritur të veprojë dhe është larguar pa lene gjurme. Policia po analizon kamerat e sigurise për bizneseve dhe banesave në zonë për të parë lëvizjet para dhe pas ngjarjes, çka mund të ndihmojë në identifikimin e autorit.

[Sh].com
LEXO EDHE:
Lac/ Vjedh makinën e parkuar, për ta shitur në qytet tjetër, policia e ndjek pas! Kamera 'i bëri gropën' 40 vjeçarit të çalë (VIDEO)

B.V/S.G/Shqiptarja.com

TAG: ishull lezhe | Lezhe | Aleks Ivanaj | lende plasese

Komento

Komente

sapa: 04/02/2024 10:28

Te tilla ngjarje do ndodhin edhe pas 100 vitesh vetem per aresyen e thjeshte :nuk ekziston shtet qe ti japë zgjidhje problemeve kaq delikate te pronave Dhe mosberja e shtetit vazhdon duke pare hezitimin e organave te drjtesise per tju vene hekurat te gjithe atyre qe e kane katandisur kete vend keshtu.

Përgjigju

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH .COM

Sondazhi i ditës:
Deklaratat publike të Arben Ahmetajt i konsideroni:

Të besueshme | Kërkon azil | S'e di

Lajme të tjera



Shpërthim i fortë me lëndë plasëse në oborrin e një banese në Ishull -Lezhë, brenda ndodhej vetëm një e moshuar (VIDEO+ EMRI)
3 Shkurt, 22:38

Lezhë/ Debate në Këshillin Bashkiak për familjet e pastreha! Të djathtët akuza bashkisë për mungesë transparence
3 Shkurt, 17:15

Ura e vjetër mbi lumin Mat rrezikon shembjen! ARRSH injoron kërkesën e prefekturës
Elvis Hila
2 Shkurt, 15:29

Drama "7 minuta" me 11 aktore të njohura shfaqet në Lezhë
Elvis Hila
1 Shkurt, 20:18

Sherr për pronën në Lezhë, plagoset 1 person! Policia shoqëron autorin
Elvis Hila
1 Shkurt, 14:17

Me eskavator e 5 kamionë 'vidhte' zhavorrin e lumit Mat, në kërkim administratori i biznesit
1 Shkurt, 13:18

Lezhë, 2 fshatarë rrihen me njëri tjetrin për pronën
1 Shkurt, 13:11

Përplasen dy makina në aksin Lezhë – Milot, i plagosur dhe 1 fëmijë i mitur
31 Janar, 17:26

Nga Kosova në Tiranë, ndalohen furgonat me ilaçe kozmetikë e bizhuteri florini! Ishin mallra kontrabandë
31 Janar, 12:31

VIDEO/ I dënuar për falsifikimin të dokumenteve të pronave në bregdetin e Lezhës, ekstradohet nga Italia 39-vjeçari (EMRI)
31 Janar, 11:50

Marrëveshja me Italinë për emigrantët, Ngjela: Rama të tregojë çfarë marrim në këmbim! I nevojshëm ndërtimi i një spitali provizor në Gjadër
30 Janar, 20:25

Skënder Minxhozi: Nuk kanë hallin e Gjadrit, por të Melonit
Skënder Minxhozi
30 Janar, 20:19

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Gerbutte

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje